
Elite Travel Agency

EKSPLORO



BOTËN

UDHËTIM NË JAPONI
09 QERSHOR 2027

FLUTURIMET

Fluturimi Shqipëri – Japoni 9 Qershor 2027 (Turkish Airlines)
Tiranë (TIA) – Stamboll (IST) : 09:35 – 12:15
Stamboll (IST) – Tokyo (NRT) : 15:50 – 08:55 (10 Qershor)

Fluturimi Japoni – Shqipëri 16 Qershor 2027 (Turkish Airlines)
Osaka (KIX) – Stamboll (IST) : 22:10 – 05:00 (17 Qershor)
Stamboll (IST) – Tiranë (TIA) : 08:00 – 08:45



ELITE TRAVEL AGENCY
ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



ITINERARI

Dita 1 & 2: Tiranë – Tokio, Kioto & Osaka

Do të takohemi me guidën rreth orës 3 orë para nisjes në aeroportin “Nënë Tereza”. Nisemi drejt Tokyos me një tranzit në Stamboll (për detaje të hollësishme rreth fluturimeve ju lutem shihni seksionin “Fluturimi”).
——————————
Mirë se vini në Japoni!

Pas mbërritjes në aeroportin e Tokyos, do të kryhet transferimi drejt hotelit ku do të kemi mundësi të lemë valixhet në recepsion.

Që në momentet e para, Tokyo ju prezanton me karakterin e tij unik. Kryeqyteti japonez është një metropol ku energjia e një prej qyteteve më dinamike në botë bashkohet me qetësinë e tempujve, kopshteve tradicionale dhe zakoneve që kanë kaluar brez pas brezi.

Do të konsumojmë drekën dhe më pas vazhdojmë së bashku me guidën drejt një prej pamjeve më ikonike të Japonisë moderne – **Shibuya Crossing**. Mijëra njerëz që kalojnë në të njëjtën kohë, dritat e reklamave dhe ritmi i qytetit krijojnë një skenë që simbolizon energjinë e Tokyos.

Pas sugjerimeve të guidës, do të keni mundësi të eksploroni atraksionet përreth Shibuya Crossing sipas dëshirës ose të ktheheni në hotel për të pushuar.

Akomodimi në **Shibuya Excel Hotel Tokyu 4*.**

Dita 3: Madhështia e Malit Fuji

Sot largohemi nga ritmi urban i Tokyos dhe udhëtojmë drejt një prej pamjeve më ikonike të Japonisë: malit Fuji.

I konsideruar si simbol kombëtar dhe një vend me rëndësi të veçantë shpirtërore për japonezët, mali Fuji ngrihet me elegancë mbi peizazhin përreth dhe prej shekujsh ka frymëzuar artistë, poetë dhe udhëtarë nga e gjithë bota.

Udhëtimi vazhdon drejt **Arakurayama Sengen Park**, një nga pikat më të fotografuara të Japonisë, ku pagoda tradicionale Chureito krijon një panoramë perfekte përballë malit Fuji.

ITINERARI



Pas kësaj ndalese vazhdojmë drejt zonës së **Liqenit Kawaguchi**, një nga pesë liqenet që rrethojnë malin. Qetësia e ujërave, natyra përreth dhe pamja madhështore e Fuji-t krijojnë një nga momentet më të bukura të këtij udhëtimi.

Një **lundrim në liqen** na lejon ta shijojmë këtë peizazh nga një këndvështrim tjetër, duke përjetuar një nga pamjet më karakteristike të Japonisë.
Në fund të ditës rikthehemi në Tokyo.

Akomodohemi në **Shibuya Excel Hotel Tokyu 4*.**

Dita 4: Tokyo - nga qetësia e tempujve te energjia e qytetit

Sot zbulojmë dy anët e Tokyos: atë tradicionale dhe atë moderne.

Dita fillon në **Tsukiji Market**, një vend ku mund të ndiejmë më nga afër kulturën gastronomike japoneze dhe dashurinë e këtij vendi për ushqimin cilësor.

Udhëtimi vazhdon drejt **Senso-ji Temple**, tempullit më të vjetër budist të Tokyos. Përmes portës tradicionale Kaminarimon dhe rrugës Nakamise, do të zbulojmë një pjesë të qytetit të vjetër, me dyqane tradicionale, ushqime lokale dhe atmosferën karakteristike japoneze.

Në drekë vizitojmë zonën e **Meiji Jingu Shrine**, një tempull Shinto i vendosur mes një pylli të gjelbër në zemër të qytetit. Këtu largohemi për pak nga ritmi i shpejtë i metropolit dhe hyjmë në një atmosferë më të qetë, ku traditat japoneze dhe lidhja me natyrën janë ende pjesë e jetës së përditshme.

Pas kësaj do të vizitojmë **Odaiba**, një atraksion turistik me pamje fantastike të “Urës së Ylberit”.

Akomodohemi në **Shibuya Excel Hotel Tokyu 4*.**

Dita 5: Kioto dhe treni Shinkansen

Sot fillojmë një nga momentet më të veçanta të udhëtimit: nisjen drejt Kyoto-s me trenin legjendar japonez **Shinkansen**.

Nuk është vetëm një transfertë, por një eksperiencë më vete, ku shpejtësia, komoditeti dhe pamjet që ndryshojnë gradualisht nga qyteti drejt peizazheve tradicionale japoneze krijojnë një tjetër kujtim të paharrueshëm.

Kyoto, ish-kryeqyteti i Japonisë, është qyteti ku historia vazhdon të jetojë. Tempullë të lashtë, kopshte tradicionale, rrugica historike dhe tradita të ruajtura prej shekujsh e bëjnë këtë një nga vendet më autentike të vendit.

ITINERARI



Vizita jonë fillon me Kiyomizu-dera, një tempull madhështor i vendosur mbi kodër, i njohur për arkitekturën prej druri dhe pamjet spektakolare mbi qytet.

Më pas do të ecim nëpër rrugët tradicionale Ninenzaka dhe Sannenzaka, ku shtëpitë prej druri, çajtoret dhe dyqanet artizanale krijojnë ndjesinë e një udhëtimi në Japoninë e vjetër.

Dita përfundon në Gion, lagjja tradicionale e Kyoto-s, ku ende mund të ndihen gjurmët e kulturës së geishave dhe atmosferës së Japonisë klasike.

Për ta bërë eksperiencën edhe më autentike, do të keni mundësinë të përjetoni një ceremoni tradicionale çaji dhe eksperiencë me kimono (aktivitete opsionale).

Akomodohemi në **Hotel Monterey Kyoto 4*.**

Dita 6 : Nga tempujt e artë te pyjet magjike të bambuve në Osaka

Dita e sotme na sjell një tjetër përjetim të veçantë të Kyoto-s, duke kombinuar arkitekturën tradicionale japoneze me bukurinë e natyrës.

Fillojmë me një nga pamjet më ikonike të qytetit: **Kinkaku-ji**, i njohur si Pavijoni i Artë. I vendosur përballë një liqeni të qetë, tempulli reflekton në ujë fasadën e tij të mbuluar me ar, duke krijuar një nga skenat më elegante dhe fotografuara të Japonisë. Ky vend, dikur një vilë pushimi për një nga figurat më të fuqishme të historisë japoneze, sot përfaqëson një nga thesaret më të bukura të trashëgimisë kulturore të vendit.
Më pas udhëtimi vazhdon drejt zonës së **Arashiyama**, një prej vendeve më të famshme të Kyoto-s për bukurinë natyrore dhe atmosferën e saj unike.

Një nga momentet më të veçanta të ditës është udhëtimi me trenin panoramik **Sagano Romantic Train**, i cili përshkon luginat, malet dhe peizazhet natyrore përgjatë lumit Hozugawa. Gjatë rrugës, natyra japoneze shfaqet në të gjitha ngjyrat e saj – nga gjelbërimi i verës te ngjyrat e arta të vjeshtës.

Pas kësaj eksperience vazhdojmë në këmbë drejt **Arashiyama Bamboo Grove**, një nga peizazhet më magjepsëse të Japonisë. Shtigjet mes bambuve të larta krijojnë një atmosferë të qetë dhe pothuajse surreale, duke e bërë këtë një nga momentet më të paharrueshme të udhëtimit.

Para largimit nga Kyoto, do të shijojmë edhe pamjen nga **Togetsukyo Bridge**, ura historike që hap një panoramë të bukur mbi lumin dhe malet përreth.

Në fund të ditës vazhdojmë drejt Osaka-s, qytetit që na pret me një atmosferë krejt ndryshe: më dinamike, më moderne dhe plot jetë.

Akomodohemi në **Osaka Excel Hotel Tokyu 4*.**

ITINERARI



Dita 7: Osaka

Osaka është një qytet me energji shumë më të veçantë nga të tjerët. Ndryshe nga qetësia tradicionale e Kyoto-s apo ritmi futurist i Tokyos, Osaka të mirëpret me një atmosferë më të gjallë, me njerëz më të hapur dhe një kulturë gastronomike që është pjesë e identitetit të saj.

Dita fillon me **Osaka Castle**, një nga simbolet më të rëndësishme të qytetit dhe një dëshmi e historisë së Japonisë. I rrethuar nga kopshte dhe hapësira të gjelbra, ky kompleks na sjell më pranë periudhës së samurajve dhe historisë së bashkimit të Japonisë.

Më pas vazhdojmë drejt **Umeda Sky Building**, një nga ndërtesat më karakteristike të Osaka-s. Nga platforma panoramike hapet një pamje spektakolare mbi qytetin, duke na treguar përmasat dhe energjinë e këtij metropoli modern.

Pasditja i kushtohet atmosferës së vërtetë të Osaka-s. Në rrugët e **Shinsaibashi**, një nga zonat më të famshme të shopping-ut, do të ndiejmë ritmin urban të qytetit, ndërsa në **Dotonbori** do të zbulojmë zemrën e jetës së natës dhe gastronomisë lokale.

Dritat shumëngjyrëshe, tabelat gjigante, restorantet tradicionale dhe aroma e ushqimeve japoneze krijojnë një atmosferë që nuk gjendet askund tjetër.

Kjo është mundësia perfekte për të provuar disa prej specialiteteve më të njohura të Osaka-s, si **takoyaki, okonomiyaki** dhe ushqime të tjera lokale që e kanë bërë qytetin të famshëm si “kuzhina e Japonisë”.

Akomodohemi në **Osaka Excel Hotel Tokyu 4*.**

Dita 8: Fundi i një udhëtimi të paharrueshëm në Japoni

Pas mëngjesit në hotel, lëmë valixhet në recepsion dhe do të kemi kohë të lirë për të shijuar momentet e fundit në Osaka përpara transferimit drejt aeroportit.



Gjatë ditës do të kemi mundësi të eksplorojmë qytetin në bazë të sugjerimeve që do të na japë guida ose të bëjmë shopping për të marrë copëza të vogla nga Japonia me vete.



Në orarin e përcaktuar do të kryhet transferimi drejt **Kansai International Airport**, duke mbyllur një udhëtim që na çoi përmes historisë, kulturës, natyrës dhe ritmit unik të Japonisë moderne.

Nga rrugët plot jetë të Tokyos, te qetësia e Kyoto-s, nga madhështia e malit Fuji deri te energjia e Osaka-s, kjo eksperiencë na tregon një Japoni të plotë – një vend ku e kaluara dhe e ardhmja jetojnë së bashku në mënyrën më magjepsëse.

TOKYO – SHIBUYA EXCEL HOTEL 4*

(4.3 RATING NE GOOGLE DHE 8.9 NE BOOKING)

ELITE TRAVEL AGENCY


ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA



TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)

WWW.ELITETRAVEL.AL

MONTEREY KYOTO HOTEL 4*

(4.1 RATING NE GOOGLE DHE 8.5 NE BOOKING)


ELITE TRAVEL AGENCY


ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA


TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)

WWW.ELITETRAVEL.AL

OSAKA – OSAKA EXCEL HOTEL TOKYU 4*


(4.4 RATING NE GOOGLE DHE 9.0 NE BOOKING)
















ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA

TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)

WWW.ELITETRAVEL.AL



PËRSE TË UDHËTONI ME NE?

- Paketa të kuruara me kujdes për çdo moshë dhe interes
- Eksperienca autentike kulturore në çdo destinacion. Cdo dite ka nje moment kulminant, qe eshte nje eksperience dhe nje aktvitet, Unesco Sites.
- Grupi optimal: 15–35 persona për një eksperiencë më personale
- Nuk ka kosto të fshehura – transparencë totale në çmim
- Fluturime të organizuara në grup me linja zyrtare per udhetime nderkontinentale ku bagazhet behen me checkin te plote pa dale nga aeroporti (jo low cost të papërshtatshme) – Bagazhet 23 KG gjithmone te perfshira
- Guida profesioniste dhe të përkushtuara, që flasin gjuhën tuaj
- 25 vite përvojë në organizimin e udhëtimeve cilësore
- Kujtime që zgjasin një jetë – jo thjesht një udhëtim
- Mbështetje 24/7 para, gjatë dhe pas udhëtimit
- Programe të pasura në përmbajtje kulturore dhe edukative
- Akomodim në hotele të përzgjedhura me standartin: 4 Superior / 5
- Vizat gjithmone te perfshira ne cmim

ELITE TRAVEL AGENCY
ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL

INFORMACIONE TË RËNDËSISSHME

Kushtet e Rezervimit dhe Pagesës

6.1 Për Shërbimin e paketës “Eksploro Botën”

Klienti pranon të ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm për rezervimin e Shërbimit. Pagesa për Shërbimet do të bëhet nga Klienti në mënyrën e mëposhtme:

1. Depozita

- Konfirmimi i rezervimit. Pas konfirmimit të rezervimit, Klienti do të depozitojë shumën prej 25 % të kostos totale të Shërbimit të paketës EB. Kjo depozitë siguron rezervimin e Klientit dhe i lejon Agjencisë të fillojë të bëjë rezervimet e nevojshme.
- Depozitë e Parimbursueshme: 10% e shumës totale të udhëtimit nuk do të jetë e rimbursueshme në asnjë rast nga Operatori i shërbimeve përveç në rrethanat e përcaktuara në Marrëveshje, siç është anulimi nga Operatori i shërbimeve ose ngjarjet e forcës madhore. Kjo politikë është në fuqi për të mbuluar çdo kosto të shkaktuar nga Operatori i shërbimeve në rast të një anulimi.
- Koha e Depozitës: Depozita duhet të bëhet jo më vonë se 10 ditë pas konfirmimit të rezervimit, kur rezervimi bëhet të paktën 3 muaj përpara. Kjo siguron që Operatori i shërbimeve të ketë kohë të mjaftueshme për të bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për udhëtimin e Klientit.

2. Pagesa e pjesës së mbetur të kostos totale

- Pagesa finale: Bilanci i pagesës duhet të paguhet nga Klienti jo më vonë se 45 ditë para datës së fillimit të shërbimit. Kjo i lejon Agjencisë të konfirmojë të gjitha rezervimet dhe të finalizojë të gjitha përgatitjet.
- Pagesa të Vonuara: Moskryerja e pagesave në kohë mund të rezultojë në moskonfirmimin e rezervimeve pa njoftim të mëtejshëm. Kjo politikë është në fuqi për të siguruar që Operatori i shërbimeve të mund të përmbushë angazhimet e saj ndaj ofruesve të shërbimeve.
- Tarifa për Pagesë të Vonuar: Në rast të pagesës së vonuar, Operatori i shërbimeve mund të vendosë një tarifë shtesë pagese prej 10% të shumës së papaguar. Kjo tarifë kompenson Agjencinë për punën shtesë administrative të përfshirë në trajtimin e pagesave të vonuara.

3. Për rezervimet e kryera/konfirmuara jo më herët se 45 ditë para nisjes së udhëtimit:

Për të gjitha rezervimet e kryera brenda këtij afati (jo më herët se 45 ditë para nisjes së udhëtimit deri në ditën e nisjes), rezervimi quhet i konfirmuar në momentin që është kryer 100% e pagesës.

Anulimi dhe Rimbursimet

7.1 Për Shërbimin e paketës “Eksploro Botën”

Klienti mund të anulojë Shërbimet të paketës EB në varësi të kushteve të mëposhtme:

1. Njoftimi dhe Tarifat e Anulimit

1.Njoftim më shumë se 60 ditë: Anulimet e bëra më shumë se 60 ditë para datës së fillimit të shërbimit do të kenë një tarifë anulimi prej 10% të shumës totale te paketës së turit, tarifë që mbulon kostot administrative që lidhen me anulimin e Shërbimeve të paketës EB.

2.Njoftim më pak se 59 ditë: Anulimet e bëra më pak se 59 ditë para datës së fillimit të shërbimit do të kenë një tarifë anulimi prej 40% të shumës totale të paketës së turit, tarifë që pasqyron vështirësinë e plotësimit të vendit të Klientit me një njoftim të shkurtër.

3.Njoftim më pak se 30 ditë: Nëse rezervimi i bërë nga klienti anulohet nga vetë ai më pak se 30 ditë përpara udhëtimit, klientit nuk i kryhet asnjë rimbursim nga ana e kompanisë, tarifë që pasqyron vështirësinë në rritje të plotësimit të vendit të Klientit me një njoftim të shkurtër.

4.Mosparaqitje: Në rast mosparaqitjeje, nuk do të jepet rimbursim. Kjo politikë është në fuqi sepse Operatori i shërbimeve do të kishte bërë të gjitha rregullimet e nevojshme dhe nuk do të ishte në gjendje të rikuperonte këto kosto.

5.Anulimi i paketave të shërbimit për kategorinë “Eksploro Botën” mund të realizohet vetëm ndërmjet një kërkese të paraqitur me shkrim, përmes emailit zyrtar, aplikacionit WhatsApp, ose me paraqitje fizike në zyrat e Elite Travel LCC Tiranë. Çdo kërkesë verbale, telefonike apo e paformalizuar me një dokument të shkruar nuk do të konsiderohet e vlefshme për procedurat e anullimit.

Me kryerjen e rezervimit dhe dërgimin e konfirmimit nga ana e Klientit, pavarësisht formës së tij (me shkrim, elektronik, përmes emailit, WhatsApp-it, pagesës së depozitës apo pagesës së plotë), kjo kontratë konsiderohet e pranuar plotësisht dhe pa asnjë kusht nga Klienti.

Ju lutemi për informacion më të detajuar vizitoni linkun për Kontratën me Klientin. Klikoni këtu

ELITE TRAVEL AGENCY
ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL

Elite Travel Agency

Everlasting Experiences

WWW.ELITETRAVEL.AL